



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Zhale i Predstavve



Anr.221/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyndi Haziri kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Gyltene Sylejmani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, Anr.221/2019 e datës 04.10.2019, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur – publikimit të tyre në rrjetin social i shqiptohet gjobë në lartësi prej 2,700.00 (dy mijë e shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 04.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe IKS me të cilën pretendon se me datë 04.10.2019, rrëth orës 10:47, kandidatja për deputete nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Xhevahire Izmaku, ka postuar në rrjetin social “Facebook” një fotografi me një fëmijë të mitur, nga tubimi zgjedhor në Vushtrri, siç mund të vërehet edhe nga fotoja të cilën po ua bashkangjesim kësaj ankesë, fëmija shihet i mbështjell me flamurin e PDK-së, si dhe si shenjë të përkrahjes për këtë subjekt i nejti shihet duke e bërë shenjën e gishtit që e simbolizon PDK-në. Me këtë rast parashtruesi i ankesës theksion se kandidatja për deputete nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Xhevahire Izmaku ka bërë shkelje të rregullës 13/2013 e plotësuar me rregulloren 20/2019, përfshirë Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nen 5 par.2 pika d) dhe par.3 pika b).

Subjekti politik PDK, në përgjigje në ankesë të datës 05.10.2019, konsideron se shkelja nuk është në kundërshtim me rregullën zgjedhore nr.20/2019 respektivisht me nenin 2 të kësaj rregullore, duke theksuar se nga fotografia e paraqitur në ankesë shihet qartë se personi në fjalë është mbi moshën 15 vjet, dhe po ashtu fare pranë këtij fëmu gjendet edhe prindi i tij.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës shihet qartë se fëmiu është i pajisur me materiale promovuese politike te subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), veprime këto të ndaluara sipas Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 2 par.3, pika b), c) dhe d) të kësaj dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 2 par.3, pika b), c) dhe d) të kësaj dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 2 par.3, pika b), c) dhe d) të kësaj rregulle, e cila dispozitë përcakton se: “... *asnje subjekt politik i certifikuar nuk mund të rregulle, e cila dispozitë përcakton se: “... asnje subjekt politik i certifikuar nuk mund të përfshinë personat të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjet në veprimet e mëposhtme: ...; b) bartin pankarta dhe materiale tjera promovuese gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore; c) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike për të shmangur etiketimin e mundshëm, ngacminin dhe çfarëdo ndikimi tjetër negativ të tyre; d) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike në fushatë zgjedhore me qëllim për të marrë vota emocionale të elektoratit”.*

Sa i për ketë pretendimeve të subjektit politik PDK në përgjigje në ankesë rreth moshës së fëmijëve, Paneli ka në konsiderat se duke u bazuar në foto nuk mund të vërehet qartë se çfarë moshe ka fëmija, por vendimin paneli e bazi duke u mbështetur në nenin 2 par.4 të Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike” ku thotë se: “*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të përfshijë personat të cilët i kanë mbushur 15 vjet në aktivitetet e fushatës, si vullnetar apo me pagesë, pa pasur të nënshkruar një marrëveshje të pëlqimit nga subjekti politik, prindërit dhe të miturit. Kjo marrëveshje duhet të jetë e detajuar dhe gjithëpërfshirëse*”, ndërsa subjekti politik PDK në përgjigje nuk ofruan asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetoheshin pretendimet e tyre.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur nen 2 par. 3, pika b), c) dhe d) dhe nen 2 par.4 të Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, pasi që fëmija ka qenë i pajisur me materiale promovuese politike dhe se për të nuk ka provë se është mbi moshën 15 vjeçare dhe i angazhuar sipas një marrëveshje të pëlqimit nga subjekti politik, prindërit dhe të miturit.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;

- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore janë përdorur personat e mitur dhe atë edhe duke mbajtur material promovues të subjektit politik PDK, gjë e cila është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura ligjore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë, mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë shihet qartë se nuk e ka pranuar shkeljen dhe për më tepër ka dekluarar se ky veprim i tyre nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa
Anr.221/2019 më datën 05.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet anjesa konform nenit 118.4 të LZP-së.